

**AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ALBANIA WORKER AGENCY” SH.P.K.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “ALBANIA WORKER AGENCY” Sh.p.k.

1- MIMOZA MURATI, atesia **PELLUMB**, shtetase SHQIPTARE, lindur me 16/04/1987 ne SKRAPAR, identifikohet nepermjet kartes se identitetit Nr. I75416072V;

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë “ALBANIA WORKER AGENCY” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise eshte “ALBANIA WORKER AGENCY” Sh.p.k.,

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

**NENI 3
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga “BRIGADA 8” Pallati 21. Hyrja 4, kati 9, apartamenti 38 , Tirane, Shqiperi

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

AKT THEMELIMI “ALBANIA WORKER AGENCY” SHPK

1



NENI 4

KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria “ALBANIA WORKER AGENCY” Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie të konsulences dhe sherbimeve ndaj shoqerive ne Republikën e Shqiperise dhe ne territoret e tjera dhe ka si objekt të veprimitarise së saj:

Shoqëria do te kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

1. Agjenci nderkombetare punesimi . Sherbim Ndermjetesimi ne fushen e punesimit dhe ne te gjitha fushat e tjera .Aktivitetet ne fushën e konsulencës dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore. Sherbime te keshillimit dhe rekrutimit ne kete fushe. Zhvillimi i procedurave te burimeve njerezore Trajnimi, Proces I plote rekrutimi punonjesish. Sherbime biznesi per pale te treta Brenda dhe jashte vendit .Shoqeria do te ndermjetesojë si dhe jape konsulence biznesi ne fushen e investimeve financiare, ndermjetesim ligjore per kompani dhe individe te ushtrojne aktivitet ne Republikën e Shqiperise dhe jashte saj. Konsulenca per strukturim dhe ristrukturim, planifikim dhe zhvillim te menyres se organizimit te kompanive. Sherbim perfaqesimi ndaj shoqerive tregtare, individeve dhe tregtareve, qofshin keta vendas apo te huaj. Vleresim dhe perpilimin e kontratave te kompanive para apo gjate lidhjes se marreveshjeve. Aktivitet agjencie dhe agjenti. Sherbim ndermjetesimi ne punesim, rekrutim. Informim per vendet e lira te punes. Keshillim dhe orientim per pune dhe profesion. Informacion dhe keshillim. Udhezime per punesim. vleresim te nevojave, zhvillim te karrieres apo te profesionit metodika per punesimin. Pjesemarje ne permirsimin e tregut te punes nepermjet trajnimit dhe nderhyrjeve ne permirsimin e legislacionit te tregut te punes. Sherbime ndermjetesimi ne te dy krahet per punedhenesin por edhe per punemarresin. apo sherbime ndermjetesimi te pa lidhura ngushtesisht me ceshtjet e vetem punesimit, etj). Sherbime per punedhenesit. kryesisht informacion mbi tregun e punes. sherbime te ofrimit te kandidateve te mundshem per rekrutim ne pune, informacion per programet e ndryshme te tregut te punes etj. Sherbimet e migracionit ne fushen e imigrimit edhe ate te emigrimit. Procedura ligjore per pajisjen me leje pune, viza, leje gendrimi per shtetasit e huaj ne Republikën e Shqiperise.. Ndermjetesim dhe konsulence e specializuar ne fushen e

AKT THEMELIMI “ALBANIA WORKER AGENCY” SHPK

2



prokurimeve publike, e pasurive te paluajtshme, legjislacionin e punes, ne fushen e investimeve strategjike, legjislacion bankar e financiar, tregtar dhe te drejtave te autorit. Agjensi konsulence ne fushen e marketing, media sociale, reklama etj Keshillim karriere. Ndermjetsim rekrutimi per punonjes sherbimi dhe sigurie publike; operator salle operative ne shoqeri private te ruajtjes dhe sigurise publike, operator salle operative ne banka dhe institucione financiare; roje fikse te sigurise ne shoqeri private te ruajtjes dhe sigurise publike, roje te levizshem te sigurise ne shoqeri private te ruajtjes dhe sigurise publike. Ndermjetesim rekrutimi ne fushen e Hoteleri - Turizem ne deget: (Kamarier, banakier, kuzhinier, mikprites, menaxher restoranti, menaxher hoteli, shef kuzhine, pasticier, picajol etj). Ndermjetesim rekrutimi ne fushen e Ndertim ne fushat. (Teknik ndertimi, murator, shtrues pllakash, punetor dhe specialist gipsi, bojaxhi, hekurthyes, punues artistik, hidraulik, specialist per ndertimin e catiave, specialist per ndertimin e fasadave, specialist murator ne profilin "gas-beton"; etj). Ndermjetesim rekrutimi ne fushen Politeknike Si: (Elektracist, Elektroauto, Hidraulik, Teknike Kompj uteri, Administrim Rrjeti, Web Design, Adobe Premiere, Adobe Photoshop, AutoCAD, Autodesk Map, grafik Designer, programues etj). Ndermjetesim rekrutimi ne fushen e agrikultures dhe Bujqesore si (agroteknike, hortikulture, mirembajtje ferme, punetor ferme, perpunim mishi, perpunim produkteve te qumeshtit, perpunim I agrumeve, perpunim i frutave dhe perimeve etj). Ndermjetesim rekrutimi ne fushen e aftesive te buta Si: Burime Njerezore, Asistent Zyre, Koordinator Zyre, Asistentie Ekzekutiv, Oficer dhe specialist protokolli, officer dhe specialist ceremoniali, specialialist i komunikimit publik etj

Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyrë të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të aktiviteteve te ndryshme. Pjesmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojne përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind mije Leke), i ndare në 1 pjese.Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1- MIMOZA MURATI 100,00 %

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7

AKT THEMELIMI “ ALBANIA WORKER AGENCY” SHPK

3



AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, pervec këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8 ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise "ALBANIA WORKER AGENCY" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator të shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare është emëruar MIMOZA MURATI.

NENI 9 DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, 24.10.2024

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE "ALBANIA WORKER AGENCY" SH.P.K.

MIMOZA MURATI



AKT THEMELIMI "ALBANIA WORKER AGENCY" SHPK